



Datë: 06.02.2026

Numër Protokolli: 673/2026

A.nr.2007/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.2007/2025, të datës 10.12.2025, të parashtruar nga ankuesi V.E, nga Prishtinë, kundër Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.2007/2025, e datës 10.12.2025, e parashtruar nga ankuesi V.E.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me shifër: 01-111/01-62464, i datës 10.11.2025, për kandidatët e suksesshëm, i shpallur nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, V.E (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 10.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.2007/2025, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00018705 për pozitën Zyrtar i Lartë për Menaxhimi e Projekteve, të shpallura nga Komuna e Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 11.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit, ndërsa kjo e fundit, me datë 15.12.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 20.01.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:324/2026, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.2007/2025 të datës 10.12.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7798/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 10.12.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 10.11.2025 për kandidatin e suksesshëm; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.12.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 15.12.2025; Konkursin e datës 18.09.2025; Vendimin e Kryetarit të Komunës i datës 21.10.2025 me akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Formularët e datës 05.11.2025 të vlerësimit individual të Eses; Çelësin e Eses; Formularët e datës 10.11.2025 të vlerësimit individual në intervistën me gojë; Formularin e datës 10.11.2025 për renditjen përfundimtare; Aplikacionin e ankuesit të datës 17.10.2025 me dokumentacionin e bashkangjiture me faqe prej 01-38; Aplikacionin e kandidatit L.Z të datës 24.09.2025 me dokumentacionin e bashkangjiture me faqe prej 01-20; Aplikacionin e kandidatit Sh.D-G të datës 17.10.2025 me dokumentacionin e bashkangjiture me faqe prej 01-37; Përgjigjen e datës 20.01.2026 me korrespondencën e bashkangjitur; Testin me shkrim të ankuesit, testet me shkrim të kandidatëve të suksesshëm; Vendimin e Kryetarit të Këshillit të datës 20.01.2026 me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:324/2026; Shkresën e datës 04.02.2026 dërguar nga R.H për Këshillin; Pasqyra e llogarisë së trustit për kandidatin L.Z.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është ***e pabazuar***, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Lipjanit, më datë 18.09.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00018705, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve- Profesional I”, dy (2) pozita në kuadër të Drejtorisë për Infrastrukturë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 19.09.2025 deri më 18.10.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 7 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi.

njoftuar se ka arritur të grumbulloi gjithsej 37.8 pikë, të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara me Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë”, ndërsa sipas Formularit të datës 10.11.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së intervistimit me gojë, rezulton se kandidatët që kanë marrë pikë më shumë, janë Sh.D-G me gjithsej 94.6 pikë, prej të cilave 68.2 pikë nga testi me shkrim, dhe nga intervista 26.4, si dhe kandidati L.Z me gjithsej 85 pikë, prej të cilave 60.8 pikë nga testi me shkrim ndërsa nga intervista 24.2, të cilët rezultojnë të jenë edhe kandidatë të suksesshëm në procedurën përkatëse të rekrutimit.

Ankuesi në ankesën e parashtuar në Këshilli, kundër Njoftimit numër:01-111/01-62464, të datës 10.11.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit, i publikuar me datë 05.12.2025, lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues, pretendon se të njëjti i është bërë e pa drejtë, respektivisht pretendon se vlerësimi i testit nuk ka qenë i drejtë dhe objektiv nga ana e Komisionit të Pranimi, ashtu që kërkon rishqyrtim të vlerësimit të testit me shkrim dhe arsyetimin e plotë për pikët e dhëna në testin në fjalë.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, nga analizimi i testit me shkrim të ankuesit konstatoi se i njëjti nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsej 37.8 pikë (prej të cilave 36 pikë nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 1.8 pikë nga eseja), ndërsa kandidati i suksesshëm Sh.G-D nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsej 68.2 pikë (prej të cilave 50 pikë nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 18.2 pikë nga eseja), si dhe kandidati tjetër i suksesshëm L.Z nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsej 60.8 pikë (prej të cilave 50 pikë nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 10.8 pikë nga eseja), dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me vlerësimin e eses apo testimit me shkrim, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullore (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën E Pranimi Në Shërbimin Civil ku përcaktohet: *“Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit”* si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi.”* dhe konstatoi se sistemi që funksion në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlen njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ndërsa Komisioni i Pranimi e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh se sipas formularit të testit të datës 03.11.2025 me shifër CN1881-ankuesi për vlerësimin e esesë nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsej (1.8) pikë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: *“9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. **Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.**”,* sikurse Kolegji i Këshillit konstatoi se eseja është parashtuar njësojë për të gjithë kandidatët si në vijim: *“Përshkruaj se cilat janë kompetencat vetanake të Komunës si dhe numëro emrat e drejtorive komunale në Komunën e Lipjanit të cilat njëkohësisht bartëse të këtyre*

kompetencave” dhe po ashtu Njësia e Burimeve Njerëzore e kishte përcjellë me provat e lëndës edhe çelësin e përgjigjes së Esesë, kurse ankuesi në testin me shkrim për esen përkatës ishte përgjigjur si në vijim: *“kompetencat vetanake të komunës janë që të mbikëqyrë zbatimin e ligjit në fuqi në drejtorit e ndryshme që i raportojnë Komunës. Drejtori i Administratës së Përgjithshme, Drejtori i Prokurimit, Drejtori i Financave*”, përgjigje kjo që në vlerësimin e kolegjit paraqet përgjigje jo të plotë dhe shumë larg përgjigjes adekuate, përkundër përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e suksesshëm, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet e ankuesit lidhur me vlerësimin e testit me shkrim nuk janë të bazuara, për rrjedhojë ankuesi nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se për çfarë arsye i njëjti është dashur të vlerësohet me më shumë pikë në esenë me shkrim, ngase çështja e kompetencave vetanake të komunave është e përcaktuar edhe me nenin 17 të Ligjit NR. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, kështu që ankuesi mund të bëjë krahasimin e përgjigjes së dhënë.

Mirëpo, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka analizuar në tërësi ligjshmërinë e procedurës së pranimit me RN00018705, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita *“Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve- Profesional 1”* ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **“Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Arsim i lartë i paspecifikuar; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.”**.

Duke marrë për bazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimin Nr.02/226 e të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita *Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve*, klasa Profesional 1, identifikohet me kodin SHC-0564 në kuadër të grupimit Grupi i administrimit të përgjithshëm, kurse fusha e kërkuar e arsimit përcaktohet të jetë: Arsim i lartë i paspecifikuar, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se konkursi në fjalë me shifër RN00018705 i datës 18.09.2025 është shpallur në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara nga neni 19, si dhe neni 30 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërlidhur me Shtojcën Nr.1/5: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1.

Me qëllim të konstatimit të faktit nëse kandidatët e suksesshëm i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit, Kolegji i Këshillit analizoi aplikacionin e kandidates Sh.D-G të datës 17.10.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur dhe gjeti se e njëjta posedon Diplomën e datës 15.05.2007 me numër:1678 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, përmes së cilës dëshmohet fakti se e njëjta ka mbaruar studimet në Fakultetin Ekonomik dhe ka fituar gradën Ekonomiste e Diplomuar, kurse lidhur me përvojën e punës posedon Vërtetimin e datës 04.09.2015 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të ProCredit Bankes përmes së cilës dëshmohet fakti se e njëjta ka punuar në këtë institucion që nga data 12.03.2007 e deri me datë 07.08.2015, dhe po ashtu posedon aneks kontratën e datës 07.06.2024 të lëshuar nga Finca, sikurse këto dy dëshmitë e marrëdhënies së punës i mbështetë edhe me pasqyrën e llogarisë së Trustit, ashtu që kandidatja në fjalë i ka plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit përkatës.

Ndërsa, pas analizimit të aplikacionit të kandidatit tjetër të suksesshëm L.Z të datës 24.09.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur, Kolegji i Këshillit konstatoi se i njëjti posedon Diplomën e datës 10.10.2013 me numër:934/13 të lëshuar nga Kolegji AAB, përmes së cilës dëshmohet fakti se i njëjti ka mbaruar studimet themelore universitare në Programin Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe ka fituar gradën Baçelor, kurse lidhur me përvojën e punës posedon Kontratën nr.03-466-2024 të datës 25.03.2024 lëshuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përmes së cilës dëshmohet se i njëjti ka punuar në këtë institucion nga data 22.03.2024 e deri me datë 04.06.2024 apo në kohëzgjatje prej dy (2) muaj, e dymbëdhjetë (12) ditë, dhe po ashtu posedon Referencën e datës 27.05.2025 të lëshuar nga Kompania Dukagjini në të cilin përshkruhet se i njëjti ka pasur marrëdhënie punë me këtë kompani që nga data 01.10.2009, si dhe ka bashkangjitur kontrata pune, njëra e datës 01.01.2022 në kohëzgjatje prej një vitit nga 01.01.2022 e deri me datë 31.12.2022, kontrata tjetër e datës 01.01.2021, në kohëzgjatje prej një viti nga 01.01.2021 e deri me datë 31.12.2021, si dhe kontrata tjetër e datës 03.01.2024, në kohëzgjatje prej një viti nga 03.01.2024 e deri me datë 31.12.2024, dhe përvoja e punës e deklaruar në sektorin privat përputhet edhe me pasqyrën të plotë të llogarisë nga Trusti, të cilën sistemi i SMIBNJ-së e gjeneron në mënyrë automatike për të gjithë kandidatët në procedurë të rekrutimit, prandaj në rrethanat e rastit konkret Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit ka zbatuar drejtë dispozitat e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1 i Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçantat, sipas shpalljes së konkursit”, pasi që kandidatët e suksesshëm i kanë plotësuar kriter e përcaktuara si në konkursin e shpallur të datës 18.09.2025 me numër reference RN00018705, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve”.

Andaj, nga se u tha si më lartë, në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit nuk është e bazuar, ashtu që ndryshohet Njoftimi i vlerësimit përfundimtar për kandidatë e suksesshëm i datës 10.11.2025, ka mbetur në fuqi sikurse në dispozitivin këtij vendimi pasi procedurat e rekrutimit në fjalë janë zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “1. Pranimi në detyrë i nëpunës/it civil, nëpunës/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunës/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese” Sikurse edhe konkursi ka qenë i hapur në pajtueshmëri me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, prandaj ankesa e ankuesit është refuzuar për arsytet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2007/2025, datë 06/02/2026.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit V.E;
- Komunës së Lipjanit (Kryetarit të Komunës, Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.